



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2022:149809

Datë: 14.03.2025

Numri i dokumentit: 06990188

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.145/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.Xh nga fshati ..., komuna Vushtrri, të cilin e përfaqëson sipas detyrës zyrtare av. Beqir Halili me seli të zyrës në Vushtrri, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe *Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.I.nr.86/2022 të datës 26.01.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 11.03.2025, në praninë e Prokurorit të Shtetit Shaqir Sedolli, të pandehurit F.Xh dhe mbrojtësit av. Beqir Halili, më datë 11.03.2025 shpalli publikisht, ndërsa me datë 14.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri: F.Xh, nga i ati B..., e ëma H..., e vajzërisë P..., i lindur më ..., në Gjermani, tani me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Vushtrrisë, me numër personal ..., të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

SHPALLET FAJTOR

I. SEPSE: Deri me datë 16.03.2021 rreth orës 15:20, në rrugën “...” në Vushtrri, përballë kompleksit banesor “...”, në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm mbi armët, ka poseduar pistoletën e markës TT, M-57, me numër serik 55007, kalibrit 7.62mm, me tëtë copë fishek.

Me këtë ka kryer veprën penale ‘*Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve*’ nga neni 366 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

II. Me datë 16.03.2022 rreth orës 15:20, përballë kompleksit banesor “Dijari” në Vushtrri, në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm mbi armët ka përdorur pistoletën e markës TT, duke shtënë në ajër,

Me këtë ka kryer veprën penale ‘*Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm*’ nga neni 367 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 46, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 269, 276, 364, 449 dhe 450 të KPPK-së.

## E G J Y K O N

I. Për pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej 800€ (tetëqind) euro, i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Për pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Me pëlqimin e të pandehurit, e në bazë të nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë 800 (me fjale: tetëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar të paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit, dënim më gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (euro) gjobë të papaguar, me 1 ditë burgim.

Gjykata në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit:

## I S H Q I P T O N

IV. DËNIM UNIK ME GJOBË në shumë prej 1600 euro (me fjalë: njëmijë e gjashtëqind), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, dënimin me gjobë gjykata do t'ia zëvendësoj më dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet më 20 (njëzet) euro gjobë të papaguar.

V. URDHËROHET – Konfiskimi i përhershëm i armës TT, M-57, me numër serik 55007, kalibrit 7.62mm, me tëtë copë fishek.

VI. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumë prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumë prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.86/2022 të datës 26.01.2023 kundër të pandehurit F.Xh nga fshati ..., komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe *Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Shaqir Sedolli, i pandehuri F.Xh së bashku me mbrojtësin e tij av. Beqir Halili.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri F.Xh ka deklaruar se ndjehet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, kjo ka qenë hera e tij e parë që paraqitet në gjykatë, është penduar thellë dhe i ka

premtuar gjykatës së në të ardhmen nuk do të posedoje e as të përdorë armë dhe se që nga ajo ditë më nuk ka pasur armë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje dispozitat e KPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, është bërë në mënyrë vullnetare dhe i pandehuri i kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, andaj ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë. Andaj, nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit, përcaktimit të llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ashtu që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, faktin që i njëjti përveç armës, ka pasur edhe tetë fishekë municion, e ka mbajtur armën me vete rrugëve, e po ashtu prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale dhe nëse nga ajo rezulton se i pandehuri është i dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese dhe e kundërta nëse nuk është dënuar më parë, ta merr parasysh se rrethanë lehtësuese.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pas konsultimit me të pandehurin, i pandehuri e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, pa kurrfarë imponimi, me vetëdije të plotë për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë bazohet në provat të cilat janë propozuar në aktakuzë, prandaj gjykatës i ka propozuar që ta pranojë pranimin e fajësisë. Po ashtu i ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit të i merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë: pranimi i fajësisë, se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, se është i gjendjes së varfër ekonomike, se është penduar dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, dhe se me një dënim të kushtëzuar do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë në ligj.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: raporti fillestar i incidentit i datës 16.03.2022, kallëzimi penal i datës 22.03.2022, procesverbal i marrjes në pyetje të të pandehurit i datës 16.03.2022, procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitarit G.L i datës 16.03.2022, raporti i oficerit i datës 16.03.2022, vërtetimi mbi armën e konfiskuar i datës 16.03.2022, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 16.03.2022, fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, deklarata e të pandehurit F.Xh, e dhënë në zyrën e prokurorisë me datë 26.07.2022, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7,500) euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuarit për veprën penale nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë në shumë prej tetëqind (800) euro, të cilin dënim është obliguar i pandehuri që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuarit për veprën penale nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, mirëpo konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi me burgim prej 6 (gjashtë) muajsh, është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej tetëqind (800) euro, të cilat dënime duhet të paguhen në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata, pas shqiptimit të dënimeve për secilën vepër penale të kryer në bashkim real, konform nenit 76 par. 1 dhe 2 nën par 2.4, të akuzuarit i shqiptoj dënim unik në shumë 1600 (njëmijë e gjashtëqind) euro, të cilin dënim është obliguar i pandehuri që ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar,

dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burg, ku 1 (një) ditë burgim, do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro të gjobës të papaguar.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese për të pandehurin ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore, ndërsa në kuadër të rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e kësaj veprë penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë vepra penale, më parë i pa gjykuar.

Ashtu që gjykata, pasi i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 71 par. 1 nën par. 1.3, të KPRK-së, për të zbutur dënimin me burgim, dhe me këtë rast gjykata duke zbatuar nenin 72 par. 1 nën par. 1.5 të KPPK-së, ku përcaktohet se *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”*, andaj gjykata pasi që gjeti rrethanat lehtësuese të përshkruara si më lartë, zbuti dënimin e të pandehurit për veprën penale nga pika II e dispozitivit, në të cilin është paraparë shqiptimi i dënimit me burgim prej 1 deri në 8 vite, e që dënimin me burgim e zbuti nën dënimin minimal prej 1 (një) viti, duke i shqiptuar të pandehurit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, e të cilin me pëlqimin e të pandehurit e konform neni 44 par. 1 të KPRK-së, e ka zëvendësuar në dënim me gjobë.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se në rastin konkret, edhe me këto dënime të shqiptuara ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me konfiskimin e armës, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimin lidhur me konfiskimin e armës, gjykata e ka marr në bazë të nenit 269 par.1 KPPK-së e në lidhje me nenin 276 KPPK-së, pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari nuk posedonte leje, e as autorizim për përdorimin e armës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.145/2023, datë 14.03.2025

Zyrtarja Ligjore  
Arta Jusufi

Gj y q t a r i  
Naim Rekalio

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimet të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.